

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ALBANIA JOYFUL ENGLISH”**

Në bazë të ligjit Nr.7512 datë 10.08.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismes së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit” si dhe të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për shoqëritë tregtare”, me vullnetin e tyre të lirë të shprehur në nënshkrimin e këtij Akti, sot më datë **20/11/2019.**, Themeluesit:

Elizaveta Biba, shtetase ruse, e bija e Lev, lindur në Rajonin e Moskës, USSR, Rusi, me datëlindje 21.08.1982, banuese në Tiranë ne adresen Rr. Pandi Dardha, mbajtëse e pashaportës me Nr.4284775.

Deklarojnë se ka vendosur të nënshkruaj këtë kontratë themelimi për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë referuar si Shoqëria), aktiviteti i së cilës rregullohet nga Akti i Themelimit dhe Statuti duke respektuar edhe kërkesat e legjislacionit shqiptar për shoqëritë tregtare

Neni 1-Emërtimi

Emërtimi i shoqërisë është **“ALBANIA JOYFUL ENGLISH” SH.P.K**

Ne të gjitha aktet e dokumentat që dalin nga shoqëria emertimi i saj do të paraprihet (ose do të ndiqet menjëherë) nga inicialet “SH.P.K” dhe nga shpallja e kapitalit themeltar.

Neni 2-Vëndndodhja e selisë

Selia zyrtare e shoqërisë ndodhet ne Tirane Ruga Osman Myderizi, Nd.2, H.7, Ap.5

Neni 3- Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë do të jetë pa afat, duke filluar prej datës së rregjistrimit të saj në Qendren Kombetare te Rregjistrimi.

Neni 4- Objekti i veprimtarisë

Objekti i shoqërise është si më poshtë:

- Import librash, materiale mesimore, materiale shoqeruese per metoden e mesimedhenjes dhe materiale marketingu.
- Eksport librash, materiale mesimore, materiale shoqeruese per metoden e mesimedhenjes dhe materiale marketingu
- Sherbim mesimedhenje gjuhes angleze
- Sherbim informues
- Sherbime trajnimi per mesimdhene
- Aktivitete te ndryshme gjate vitit si: art, kercim, muzike, sporte te ndryshme etj. ne bashkepunim me subjekte te tjera.

Kryerja e çdo operacioni ekonomik e juridik, prodhues dhe tregtar e financiar, që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me objektin e veprimtarisë së shoqërisë, për të cilin, ne baze



te legjislacionit shqiptar, kërkohet leje e posaçme nga organet kompetente të administratës publike, do të realizohet vetëm pasi të jetë siguruar leja përkatëse.

Neni 5- Kapitali Themeltar

1) Kapitali themeltar i shoqërise është 15.000(pesembedhjetemije)lek

Pjesëmaria e themelueses ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributin e saj si me poshtme:

1. **Elizaveta Biba, e bija e Lev, lindur në Rajonin e Moskës, USSR, Rusi, me datëlindje 21.08.1982, banuese në Tiranë ne adresen Rr. Pandi Dardha, mbajtëse e pashaportës me Nr.4284775 Zoteruese e 1 (nje) kuote me vlerë te pergjithshme 15.000 (pesembedhjetemije)lek qe perben 100% te kapitalit themeltar te shoqerise.**

Aksionari duhet te mbajne rreziqe (borxhet, detyrimet ligjore dhe financiare, etj) ne baze te perqindjes perkatese

Neni 6-Kontributet dhe pjesët e kapitalit themeltar

Sipas kontributeve në kapitalin themeltar të shoqërisë eshte vetem një pjese e cila perben 100 % te kapitalit te shoqerise.

1. Kapitali i mesiperm eshte nenshkruar dhe shlyer teresisht ne lek nga ortaku i vetem Znj Elizaveta Biba e bija e Lev e datelindjes 21.08.1982

Kuota me vlerë te pergjithsme 15.000 LEK , qe perbejne 100% te kapitalit themeltar te shoqerise.

Pjeset e kapitalit themeltar nuk mund te perfaqesohen nga letra me vlerë te tregtueshme dhe as me kontribute ne sherbime.

Ortaku pergjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise

Neni 7- Transferimi i pjesëve të kapitalit

1. Pjesët e kapitalit janë të transferueshme ndaj të tretëve sipas procedurave të parashikuara nga Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për shoqeritë tregtare" dhe nga statuti i shoqërisë.

Neni 8 - Administrimi

1. Shoqëria administrohet nga një ose disa administrator, qofshin këta edhe jo ortak, të cilët emërohen ose shkarkohen nga Asambleja e Zakonshme.
2. Administratori është përfaqësuesi ligjor i shoqërisë. Ai ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët, në interes të shoqërisë, dhe në emër të saj në të gjitha rrëthanat që kanë lidhje me objektin e Shoqërisë, me përashtim të kompetencave që ligji apo Statuti ja jep Asamblesë së Ortakëve.

3. Administratori i parë i shoqërisë është:

Znj Elizaveta Biba e bija e Lev e datelindjes 21.08.1982 caktohet si administratore e shoqerise me afat 5 vjeçar i rinovueshem.

4. Të gjitha shpenzimet, taksat dhe honoraret e paguara për këtë akt dhe aktet që rrjedhin prej tij u përkasin bashkarisht dhe solidarisht nënshkruesëve në

përpestim me kontributet e tyre deri sa shoqëria të rregjistrohet në rregjistrin tregtar.

Neni 9- Të tjera

1. Shoqëria do ta ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni - 10

1. Të gjitha kundërshtimet ose mosmarrveshjet që mund të lindin gjatë funksionimit të shoqërisë ose gjatë likujdimit të saj midis ortakëve ose një ose më shumë ortakëve dhe Shoqërisë do të diskutohen në menyre të drjetpërdrejtë midis të interesuarëve per ti zgjidhur me pajtim. Në rast të kundërt i nënshtronen juridiksonit të gjykatave kompetente në kushtet e parashikuara nga legjislacioni Shqiptar në fuqi.

Neni - 11

1. Ky Akt Themelimi është përgatitur në katër kopje të barabarta dhe të barazvlefshme.

Parë dhe miratuar në Tirane , më 20/11/2019

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Elzaveta Bilec". Below the main name is a smaller, stylized circular mark or initial.